

INFORMACIONI FINANCIAR QË PËRMBAN RAPORTI I KREDIMARRËSIT

Informacioni financiar përfshin të dhënat financiare në lidhje me kredinë/të e akorduara kredimarrësit, si dhe të dhënat financiare në lidhje me kredinë/të, në të cilat kredimarrësi shfaqet si person i lidhur.

LEXIMI I TË DHËNAVE FINANCIARE NË LIDHJE ME KREDINË/TË E AKORDUARA KREDIMARRËSIT:

1. Lloji i kredisë – njëri nga 6 opsionet, i shprehur me kodet përkatëse ose me fjalë: 0 - Kredi; 1 - Overdraft; 2 - Kartë krediti; 3 - Letër kredi; 4 - Garanci; 5 - Të tjera, 6 - Qira financiare
2. **Data e disbursimit të kredisë** – data në të cilën, fondet janë transferuar për llogari të kredimarrësit.
3. **Shuma e aprovuar e kredisë** – shuma totale, me të cilën banka është angazhuar të financojë kredimarrësin.
4. **Shuma e disbursuar e kredisë** – mund të jetë më e vogël ose e barabartë me shumën e aprovuar të kredisë.
5. **Shuma e këstit mujor** – madhësia mesatare e detyrimit mujor të kredimarrësit për një kredi të caktuar.
6. **Shuma e mbetur/Teprica e kredisë** – gjendja e detyrimit të kredimarrësit në datën e nxjerrjes së raportit.
7. **Shuma e vonuar** – pasqyron detyrimin e papaguar në kohë të kredimarrësit.
8. **Monedha / Valuta e kredisë** – njëri prej 7 opsioneve, shprehur me kodet përkatëse: 0 - Lek; 1 - Euro; 2 - Usd; 3 - GBP; 4 - Yen; 5 - CHF; 6 - Të tjera.
9. **Statusi i klasifikimit të kredisë** – njëri prej 8 opsioneve, shprehur me kodet përkatëse: 0 - Standard; 1 - Në ndjekje; 2 - Nënstandard; 3 - E dyshimtë; 4 - E humbur; 5 - E paguar; 6 - E fshirë nga bilanci; 7 - E anuluar.

Kreditë (0) – Standard dhe (1) – Në ndjekje, hyjnë në grupin e *kredive cilësore*. Kreditë (2) - Nënstandard, (3) – E dyshimtë, (4) – E humbur hyjnë në grupin e *kredive me probleme*.

10. **Historiku i klasifikimit** – pasqyron klasifikimin e kredisë për 24 periudhat më të fundit, duke filluar nga periudha aktuale.
11. **Kolaterali** – pasqyron tërësinë e kolateraleve të ndarë në rreshta, ku për secilin raportohet:
 - numri serial i kolateralit* – për pasuritë e patundshme raportohet: numri i pasurisë ose numri i hipotekës dhe/ose numri i regjistrimit dhe/ose numri i faqes; për mjetet e transportit raportohet numri i shasisë; për makineri/pajisje raportohet numri i shasisë së linjës së prodhimit.
 - *Lloji i kolateralit* – njëri prej 6 opsioneve, shprehur me kodet përkatëse: 0 – Hipotekë; 1 – Inventar; 2 – Makineri dhe pajisje; 3 – Vetura; 4 – Depozitë në cash; 5 – Të tjera; 6 – Objekt i kontratës së qirasë financiare.
 - *përshkrimi i kolateralit* – tekst i lirë, përshkrim i shkurtër i kolateralit.

Raporti për kredimarrësin pasqyron dhe një përmbledhje të totalit të kredive akorduar kredimarrësit, duke prezantuar numrin total të këtyre kredive, së bashku me disa prej të dhënave të mësipërme financiare (konkretisht të dhënat nr: 3; 4; 5; 6 dhe 7).

Leximi i të dhënave financiare në lidhje me kredinë/të, në të cilat kredimarrësi shfaqet si person i lidhur përfshin:

- tërësinë e informacionit financiar trajtuar për kredinë/të, të cilat i akordohen kredimarrësit, si dhe
- **Rolin e kredimarrësit si person i lidhur** – njëri ose disa prej 6 opsioneve, shprehur me kodet përkatëse ose me fjalë: 0 – Garantues; 1 – Bashkëshort; 2 – Drejtor; 3 – Pronar/aksioner; 4 – Bashkëkredimarrës; 5 – Firmë e lidhur.

Raporti për kredimarrësin pasqyron dhe një përmbledhje të totalit të kredive në të cilat ai shfaqet si person i lidhur, duke prezantuar numrin total të këtyre kredive, së bashku me disa prej të dhënave financiare (konkretisht të dhënat nr: 3; 4; 5; 6 dhe 7). Gjithashtu, në raportin për kredimarrësin shfaqen dhe 5 (pesë) kërkimet e fundit që subjektet bankare/financiare kanë kryer për personin apo subjektin juridik.

Në çdo rast, nëse kredimarrësi nuk është dakord me të dhënat e tij në raportin e kredimarrësit, ka të drejtë t'i drejtohet Bankës së Shqipërisë për të rishikuar/verifikuar informacionin që ekziston për të në Regjistrin e Kredive dhe për të kërkuar ndryshimet e nevojshme. Për këtë ai duhet të paraqitet pranë Zyrës së Regjistrimit të Kredive dhe të plotësojë formularin përkatës për rishikimin e të dhënave, së bashku me dokumentet shoqëruese. Për rishikimin e të dhënave nuk është e nevojshme të paguhet asnjë tarifë.